



Ky material është financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect. Radiohjalpen dhe We Effect jo domosdoshmërisht bien dakort me mendimin e shprehur. Vetëm Autori është përgjegjës për përmbajtjen.

Punoi & Redaktoi:

Jola Tomorri

Koordinatorë Projekti

Unioni “Amaro-Drom”

©Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro-Drom”

Adresa: Rr. Sulejman Pasha,

Lagjia 4, P.2, Shk.3

Telefon/Fax: 00355 4 248925 & 231391

E-mail: amarodrom@abissnet.al

Website: www.unioniamarodrom.com

Tiranë, Shqipëri

Parathënie

Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome” financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni “Amaro-Drom në zonat: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat, Baltëz-Fier dhe Savër - Lushnje.

Botimi është në funksion të aktiviteteve të projektit dhe njëkohësisht të çështjeve që lidhen me arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri.

Arsimimi i fëmijëve Rom, është një nga fushat prioritare të Unionit “Amaro-Drom” që në momentet e para të krijimit pasi “Pa arsim nuk ka zhvillim, nuk ka integrim, nuk ka të ardhme”.

Një rëndësi e veçantë nga Unioni “Amaro-Drom” i është kushtuar kujdesit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, ku një sërë projektesh të zbatuara, kanë patur në fokus edukimin parashkollor.

Vitet e hershme të jetës, janë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë në të ardhmen.

Mirëqënia dhe shëndeti i fëmijëve tanë, është një çështje që na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë aktorët të cilët kontribuojnë për arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri. Dëshiroj të falenderoj për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, donatorët, Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, drejtuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale në Korçë, Shkodër, Fier dhe Berat, Zyrën Arsimore në Lushnje, Drejtoritë dhe edukatorët e kopshteve të projektit dhe stafin e projektit.

Çdo fëmijë duhet të ndihet i vlerësuar dhe të ketë mundësi të zhvillojë potencialin e tij. Le të përpiqemi të gjithë së bashku t’u ofrojmë fëmijëve tanë një mjedis të sigurt, të ngrohtë!



Sinqerisht,
Skënder Veliu
Drejtor Ekzekutiv
U.R.SH. Amaro-Drom

Përmbajtja

Parathënie	3
I. Një vizitë e veçantë – Televizioni kombëtar suedez viziton komunitetin e Moravës	6
II. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome në Shqipëri” për vitin 2018	8
III. Mbyllja me sukses e vitit shkollor 2017-2018 dhe çelja e vitit shkollor 2018-2019	10
IV. Tryeza të rrumbullakta me ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve	12
V. Zhvillimi i aktivitetit “Historia Juaj” – Histori suksesi	16
VI. Trajnime me prindër	20
VII. Aktivitete festive	22
VIII. Shërbimi shëndetësor	25
IX. Regjistrimi civil – Histori suksesi	28
X. Eksperience personale – edukatore Natasha Qose	30

NJË VIZITË E VEÇANTË

TELEVIZIONI KOMBËTAR SUEDEZ VIZITON KOMUNITETIN E MORAVËS



*Kristo Myrteli, Angjelo Myrteli, Martino Myrteli, Patrisja Myrteli,
Kristi Metani, Henrik Crona
©Jola Tomorrow*

Në shtator të vitit 2018 një ekip nga televizioni kombëtar suedez SVT, shoqëruar nga znj. Malin Persson Giolito, shkrimtare dhe avokate e mirënjohur në Suedi, së bashku me përfaqësues të We Effect, vizituan kopshtin e lagjes Stan në Moravë. Gjatë vizitës ata patën mundësi të njiheshin nga afër me punën e bërë në kudër të këtij projekti si dhe me përfituesit e tij.

Rrugëtimi i tyre nisi në një nga lagjet e Beratit ku është i përqëndruar komuniteti rom e njohur si “ish-pjeshkorja”, ku ekipi pati mundësinë të njëhej me kushtet e vështira në të cilat jetonte komuniteti atje si dhe me pamundësitë e fëmijëve për të ndjekur kopshtin, për shkak të pamundësive financiare, të distancës së largët me lagjen, nivelit të ulët të ndërgjeggjësisimit tek prindërit etj.

Në ditët në vijim vizita u përqëndrua në zonën e Moravës, ku Amaro-Drom punon tashmë prej rreth 4 vitesh në kuadër të këtij projekti për të fuqizuar komunitetin dhe mbështetur fëmijët rom dhe jo rom drejt rrugës së dijes.

Ekipi u njoh me ambjentet e ngrohta dhe ftuese të kopshtit si dhe stafin edukativ. Standardet e kopshtit, si nga ana infrastrukturore ashtu edhe nga programi i edukimit u përqaftuan dhe përshëndetën nga grupi i punës. Gjithashtu miqtë tanë suedezë patën mundësi të ishin pjesë e disa aktiviteteve që synojnë përmirësimin e shërbimeve të fëmijërisë së hershme dhe ndërgjeggjësisimit të prindërve (nënave) si “Historia Juaj” dhe shërbimi shëndetësor. Intervista u zhvilluan me aktorët e zbatimit të projektit dhe prindërit përfitues të cilët ndanë eksperiencat e tyre personale dhe përcollën mesazhe pozitive rreth rëndësisë së edukimit të fëmijëve.

Përshtypjet rreth kësaj ndërhyrjeje janë të paraqitura në intervistën e mëposhtme, të dhënë nga shkrimtarja dhe avokatja **Malin Persson Giolito**.

Çdo vit Children of the World dhe televizioni suedez SVT (Suedi) realizon një mbrëmje gala me qëllim mbledhjen e fondeve për të ndihmuar fëmijët e varfër kudo në botë. Reportazhi mbi vizitën e kryer në kopshtin e Moravës i mbështetur nga Radiohjalpen dhe We Effect në Shqipëri,



©Henrik Crona

nëpërmjet projektit të zbatuar nga Amaro-Drom, u transmetua gjatë mbrëmjes gala në televizionin kombëtar suedez. Shfaqja gjeneroi rreth 5 milion Euro, të cilat do të shkojnë për fëmijët në nevojë kudo në botë. Amaro Drom mbështetur nga partneri i tij We Effect, treguan edhe njëherë se si me pak mbështetje e me shumë punë e përkushtim mund të arrihen rezultate të prekshme në drejtim të përmirësimit të jetës e fëmijëve në nevojë.

INTERVISTË E SHKURTËR ME MALIN PERSSON GIOLITO, AUTORE DHE JURISTE SUEDEZE

Malin Persson Giolito

© Malin von. Strauss



Përshëndetje Malin!

Në mes të shtatorit ju udhëtuat me televizionin suedez drejt Shqipërisë, për të vizituar projektin që ka në fokus arsimin parashkollor që We Effect dhe Amaro-Drom po zbatojnë, me mbështetjen e Children of the World. Cilat janë përshtypjet tuaja?

- Unë kurrë nuk kam dyshuar se arsimi është çelësi për të ndryshuar situatën e komunitetit rom. E gjitha ka të bëjë me ndjekjen e kopshtit dhe shkollës nga fëmijët. Është e qartë që projekti për arsimin parashkollor bën ndryshimin. Mund të them se kisha frikë se pas këtij udhëtimi do të kthehesha në shtëpi përsëri me një ndjenjë pesimizmi, por ndodhi krejt e kundërta. Ndiheva shumë optimiste.

- Cilat ishin mendimet tuaja përpara udhëtimit?

- Para udhëtimit, mendoja shumë për gjendjen e komuniteteve romë në Evropë. Dhe si përpiqemi të injorojmë problemet e varfërisë dhe ato sociale që ndeshim në jetën tonë të përditshme, për të qenë në gjendje të ecim përpara me jetën tonë të rehatshme. Doja të takoja njerëz me të cilët të ndjeja një lidhje. Dhe sapo u shtërgova dorën, u mbusha me shpresë. Është e habitshme se sa shumë mund të arrijnë njerëzit vetëm me pak ndihmë. Njerëzit që takova duan vërtet të ndryshojnë jetët e tyre - dhe ata po e bëjnë këtë.

- Projekti gjithashtu përfshin nënat, çfarë mendoni për këtë?

- Është tejet e rëndësishme të përfshihen nënat në këtë proces. Fëmijët mund të shkojnë dhe të ndjekin shkollën vetëm nëse prindërit i çojnë në shkollë. Dhe fëmijët e prindërve të lumtur kanë rezultate edhe më të mira. Përveç kësaj, nënat janë të reja, kanë gjithë jetën e tyre para. Ato nuk janë një brez i humbur dhe as nuk dorëzohen. Është shumë e guximshme të përpiqesh të mësosh të lexosh kur je i rritur. Kam takuar gra të mrekullueshme dhe është e lehtë të lidhesh me to e t'i kuptosh, edhe pse jetojnë jetë të ndryshme.

Autore e intervistës: Malin von. Strauss

AKTIVITETET E ZHVILLUARA NË KUADËR
TË PROJEKTIT
“PLATFORMA KUNDËR VARFËRISË SË FËMIJËVE
DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL NË KOMUNITETET
ROME NË SHQIPËRI – FAZA II”
PËR VITIN 2018





PËRFUNDIMI ME SUKSES E VITIT SHKOLLOR 2017-2018 DHE ÇELJA E VITIT SHKOLLOR 2018-2019

Në qershor të vitit 2018, 309 fëmijë të regjistruar në kopësht përfunduan me sukses vitin shkollor 2017-2018. Nga këta, 79 fëmijë u asistuan nga stafi lokal i Amaro-Drom për t'u regjistruar në klasë të parë për vitin shkollor 2018-2019. Për herë të parë, këtë vit, nëpërmjet projektit, u mundësua edhe pajisja me mjete kancelarike për fëmijët e kopshteve të targetuara që filluan klasën e parë.

Gjithashtu risi për këtë vit shkollor ishte se me udhëzim të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të gjithë fëmijëve nga klasa e parë në të katërt i'u shpërndanë falas materialet kryesore didaktike.

Përpara fillimit të vitit shkollor 2018-2019, koordinatorët lokalë kanë realizuar takime intensive me prindërit dhe vizita në shtëpi, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për regjistrimin e fëmijëve në kopësht dhe në shkollë. Stafi i projektit lehtësoi procesin e regjistrimit të fëmijëve në kopshte dhe në shkolla nëpërmjet informimit të prindërve lidhur me dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e fëmijëve në arsimin publik.

Si përfundim 287 fëmijë u asistuan për t'u regjistruar në 6 kopshtet e targetuara për vitin akademik 2018-2019. Të gjithë fëmijët u pajisën me libra didaktik, kancelari dhe uniforma.



Rajmonda Halili, Aleksander Halili

Vlen të përmendet që Amaro-Drom ishte pjesë e grupit të punës të krijuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit për hartimin e udhëzimit për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor.





TRYEZA TË RRUMBULLAKTA ME OFRUESIT PUBLIKË DHE PRIVATË TË SHËRBIMEVE

Me qëllim nxitjen e dialogut dhe lobimin për çështje të rëndësishme që targetojnë shërbimet e fëmijërisë së hershme por jo vetëm, mes aktorëve publikë e privatë të shërbimeve, u zhvilluan 2 tryeza të rrumbullakta në Lushnje dhe Korçë.

Të pranishëm ishin përfaqësues nga Prefektura, Bashkia (zyra e gjëndjes civile, njësia për mbrojtjen e fëmijëve), Zyra Arsimore Lushnje/Drejtoria Arsimore Rajonale Korçe, Drejtoria e Shendetit Publik, stafet edukative të kopshteve përkatës dhe drejtorët, aktivistë, prinder dhe përfaqësues të organizatave lokale etj.

Fjala hapëse e takimeve u bë nga Drejtori Ekzekutiv i Unionit “Amaro-Drom” i cili shprehu falenderimet e tij për aktorët lokalë për pjesëmarrjen në aktivitet si dhe për angazhimin e tyre në ofrimin e shërbimeve ndaj anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian, veçanërisht fëmijëve.

Z. Velu gjatë fjalës së tij theksoi rëndësinë e bashkepunimit me institucionet qeveritare që Unioni Amaro-Drom ka patur ndër vite në kuadër të zbatimit të projekteve të ndryshme, ndër të cilat edhe projekti i financuar nga We Effect dhe Radiohjalpen me fokus edukimin parashkollor. Z. Velu i kushtoi vëmendje edhe rëndësisë së edukimit në të gjitha hallkat e tij dhe veçanërisht, atij parashkollor, duke u ndalur edhe në situatën aktuale përsa i përket numrit të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve rom dhe egjiptian në zonat përkatëse.

Duke marrë shkas edhe nga prezenca e aktivistëve dhe organizatave lokale të pranishme në takim u theksua edhe njëherë rëndësia e koordinimit të punës ndërmjet insitucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile për ofrim sa më të mirë të shërbimeve.

Ne vijim të aktivitetit koordinatorja e projektit, znj. Jola Tomorri foli për arritjet e deritashme të fazës së dytë të projektit për secilin nga objektivat, sfidat dhe planet për të ardhmen. Pjesëmarrësit në aktivitet u njohën më specifikisht me aktivitetet e zhvilluara dhe rezultatet e tyre duke përfituar kështu një pasqyrë të plotë të kontributit të ofruar në kuadër të këtij projekti në përmirësimin e aksesit të fëmijëve rom dhe të disavantazhuar jo-rom në shërbimet e fëmijërisë së hershme.



Në pjesën e dytë të aktivitetit, pjesëmarrësit u ftuan të diskutojnë në lidhje me kontributin e tyre në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve të fëmijërisë së hershme dhe rreth çështjeve kryesore që shqetësojnë komunitetin. Në Lushnje ishte e pranishme nën-Prefektja e cila u shprehu mirënjohjen për kontributin e dhënë dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Përfaqësuesit e Bashkisë dhe të Qendrës së Zhvillimit Ekonomik falenderuan projektin për kontributin e ofruar për fëmijët e kopshteve. Ata u shprehën se për shkak të kufizimeve financiare, jo të gjitha nevojat e kopshteve mund të plotësohen. Ndaj theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të mund të zbuten sa më shumë problematikat që kopshtet hasin. Gjithashtu ndërmjet drejtoreve të kopshteve në Korçë dhe përfaqësuesve të Qendrës së Zhvillimit Ekonomik u diskutua për nevoja konkrete të kopshteve që janë në varësinë e institucioneve që lidhen me përmirësimin e higjienës dhe infrastrukturës.

Përfaqësuesit e drejtorive arsimore u shprehën pozitivë për ndërhyrjen. Ata e vlerësuan më së shumti faktin që po punohet sistematikisht me arsimin parashkollor pasi që aty fillon zgjidhja e problemit të mos frekuentimit të shkollës apo braktisja e saj. Megjithë përpjekjet, ende ka nevojë për ndërhyrje pasi shkalla e braktisjes së shkollës është ende e konsiderueshme në mesin e fëmijëve rom dhe egjiptian. U kërkuar të shihej mundësia e bashkëpunimit për të mbështetur edhe më shumë zona pasi nevojat janë të larta.

Përfaqësuesit e Zyrës së Gjendjes Civile referojnë se situata e regjistrimit civil për fëmijët rom është përmirësuar disi por ende ka nevojë për ndërgjegjësim dhe asistencë në trajtimin e rasteve të vështira të cilat nuk mbulohen. Staf i Amaro-Drom shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në raste të tilla nëse do të paraqiten pranë gjendjes civile.

Përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore gjithashtu u shprehën për problematikat e shëndetit të popullatës në këto zona sidomos përsa i përket sëmundjeve kronike dhe atyre të lidhura me higjienën. Një tjetër temë e diskutuar në këto takime ishte ndërhyrja në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta për të cilët nuk sigurohet mësues mbështetës, edhe pse ligjerisht është e parashikuar një masë e tillë. Amaro-Drom dhe organizatat e tjera të pranishme i bënë thirrje edhe njëherë përfaqësuesve të zyrave arsimore për t'u treguar bashkëpunues dhe për të zbatuar këtë masë.

Aktiviteti i organizuar në Lushnje u pasqyrua gjithashtu në edicionin kryesor të lajmeve në televizionin lokal në Lushnje, ku ndërmjet të tjerash, lehtësuesi i projektit për regjistrimin civil theksoi rëndësinë e regjistrimit civil dhe bëri një thirrje për publikun e gjerë për të adresuar rastet e vështira të regjistrimit civil të fëmijëve që kërkojnë ndihmë administrative dhe ligjore.

HISTORIA JUAJ

**AKTIVITETI QË LIDH E FORCON
KOMUNITETET E NËNAVE**

Aktiviteti **“Historia Juaj”** vazhdon të implementohet në vitin e dytë të këtij projekti. Nën timer shohin këtë aktivitet të dobishëm dhe interesant ndaj dhe interesi i tyre për të marrë pjesë është i lartë. Ky aktivitet ka pasur një ndikim pozitiv deri tani. Ai ka ndikuar në përmirësimin e aftësive prindërore të nënave rome dhe jo-rome që marrin pjesë në të. Rezultatet pozitive të këtij aktiviteti vërehen edhe nga stafet edukative, të cilët dëshmojnë se ka një rritje të interesit të fëmijëve ndaj librave e përrallave që u lexohen në kopësht si dhe përmirësim të aftësisë së përqëndrimit e të të kuptuarit të tekstit nga ana e fëmijëve.

Me librat e dhuruar gjatë aktivitetit, nënat kanë krijuar një bibliotekë të vogël për fëmijët në shtëpitë e tyre. Meqenëse fëmijët dëshirojnë që nënat e tyre t’u lexojnë librat gjatë ditës, kjo ka bërë që nëna dhe fëmija të shpenzojë edhe më shumë kohë cilësore së bashku në familje, çka nënkupton përfshirje më e madhe e nënave në zhvillimin e hershëm të fëmijëve të tyre. Ajo që është vënë re është se ky model, në mënyrë indirekte po replikohet tashmë nga nënat tek fëmijët më të rritur të familjes, kryesisht motrat. Stafi edukativ në Savër (Lushnje) referon se shpesh fëmijët më të rritur që kanë motrat ose vëllezërit në kopësht shprehin dëshirën që të marrin edhe ata pjesë në seanca dhe pastaj t’i lexojnë librat vëllezërve të tyre më të vegjël, ashtu siç bëjnë nënat e tyre në shtëpi.

Nga ana tjetër, nënat e konsiderojnë këtë aktivitet kuptimplotë, së pari sepse i ka ndihmuar ato të rivendosin besimin në të lexuarin analitik (ose duke u përpjekur të mësojnë të lexojnë në rastin e nënave analfabete) dhe së dyti, sepse është një aktivitet social ku ato mund të shkëmbejnë mendimet dhe ndajnë sfidat e tyre të përditshme për të gjetur mënyra për të mbështetur njëra-tjetrën. Disa nga sesionet organizohen në kopshte si një mënyrë për t’i afruar nënat me mjedisin arsimor. Në raste të tjera, një nënë pjesëmarrëse mirëpret nënat e tjera dhe lehtësuesen në shtëpinë e saj, për të kryer takimin atje. Kjo është gjithashtu një mënyrë indirekte për të forcuar miqësinë dhe bashkëpunimin si dhe për të fuqizuar nënat.

Anila Murati

Një histori sukesi

Anila Murati është një prej nënave të komunitetit të Baltëzës që ka marrë pjesë rregullisht në takimet e “Historia Juaj”. E ka konsideruar këtë aktivitet si mjaft domethënës për të dhe djalin e saj, i cili ndjek kopshtin Trifon Prifti në Baltëz, një nga kopshtet e mbështetur në kuadër të projektit. Për të, “Historia Juaj” ka shërbyer si një mjet për t’u lidhur edhe më shumë me fëmijët e saj dhe për të kontribuar në mënyrë më cilësore në zhvillimin dhe mirëritjen e tyre.





Rreth një vit pas pjesëmarrjes së vazhdueshme në aktivitete si nënë përfituese, Anila konkuroi për pozicionin “Lehtësuese e seancave Historia Juaj” në komunitetin e saj dhe fitoi. Tashmë ajo është e punësuar në këtë pozicion dhe kontribuon jo vetëm në komunitetin ku jeton por edhe në familjen e saj. Anila gëzon respekt të plotë në komunitetin e nënave në Baltëz dhe tashmë përbën një model pozitiv e frymëzues edhe për nënat e tjera. Së bashku ato përmirësojnë aftësitë e tyre prindërore dhe njëkohësisht dalin nga rutina e shtëpisë.

“Për mua dhe nënat e tjera, ky aktivitet shërben jo vetëm që të mësojmë se si t’u lexojmë përrallat fëmijëve dhe t’u ushqejmë

dashurinë për librin, por edhe për të dalë nga shtëpia, për t’u zbavitur me lojrat e temat që bëjmë dhe për të larguar stresin që kemi nga problemet e përditshme”, - shprehet Anila

Ajo është shumë e ndërgjegjshme për rëndësinë që ka edukimi dhe arsimimi tek fëmija i saj.



E pyetur rreth ndjesive të saj në lidhje me kalimin nga nënë pjesëmarrëse në lehtësuese të grupit të nënave ajo shprehet: "Këtu e një vit kam mësuar shumë gjëra. Ndihej më mirë me veten dhe më duket sikur ja kam arritur qëllimit për të qënë një hap më para. Jam e lumtur që kontribuoj sadopak për nënat e tjera dhe i frymëzoj pasi një ditë mund të jenë ato në vendin tim."



”

Për fëmijën tim është shumë i rëndësishëm edukimi dhe arsimimi, jo vetëm që të dijë sa më shumë e të bëhet dikush në jetë, por edhe të dijë të komunikojë me njerëzit e të ketë sjellje të mirë. Edhe në komunitetin e prindërve në Baltëz vë re një rritje të ndërgjegjësimit të prindërve për t'i çuar fëmijët në kopësht e shkollë, pavarësisht varfërisë.

“



TRAJNIME ME PRINDËR

REKOMANDIME



Tre seanca trajnimi për prindërit për secilin komunitet mbi tema të tilla si: Martesat e hershme dhe ndikimi i tyre në arsimim; Praktikën e mirë të prindërimit dhe Të Drejtat e Fëmijëve u realizuan me prindërit rom dhe jo-rom, duke synuar rritjen e kapaciteteve dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e fëmijëve. Trajnimet u kryen nga një eksperte e jashtme. Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e aftësive prindërore dhe rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për çështje të rëndësishme që u sugjeruan nga vetë prindërit gjatë seancave të mëparshme të trajnimit. Nën të përfshihen veçanërisht në diskutime, duke bërë pyetje dhe duke shkëmbyer praktikën e prindërimit midis njëri-tjetrit.

Moduli i dytë i ciklit të trajnimeve u fokusua tek fenomeni i martesave të hershme i cili është mjaft prezent në komunitetin rom dhe egjiptian por edhe në zonat rurale të Shqipërisë në përgjithësi. Nisur nga diskutimet e nxitura gjatë modulit të parë të trajnimit, ku gjatë bisedave dhe ndarjes së eksperiencave doli në pah problemi i tërheqjes nga shkolla sidomos të vajzave, si pasojë e martesave të hershme, u mendua si e nevojshme trajtimi i temës së martesave të hershme dhe të detyruara dhe pasojat e saj në edukim dhe jo vetëm, si një mënyrë për të ndërgjegjësuar prindërit e komunitetit rom dhe jo-rom në lidhje me pasojat e këtij fenomeni, i cili shpesh i atribuohet traditës.

REKOMANDIME

- ***Realizimi i fokus grupeve midis antarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në lidhje me temën e martesave të hershme sidomos tek vajzat (vetëm me nënat pasi aty mund të ndihen më të lira për të ndarë eksperiencat e tyre dhe në këtë mënyrë për të ndërgjegjësuar njëra tjetrën në lidhje me këtë problem);***
- ***Të insistohet në rritjen e numrit të prindërve meshkuj në fushatë, trajnime pasi janë përgjithësisht ata që marrin vendimet në lidhje me fëmijët e tyre;***
- ***Fuqizimi i adoleshentëve me informacion, për t'ju paraprirë atyre pasojat negative të martesave të hershme dhe për ti njohur me të drejtën e tyre ligjore për të refuzuar një martesë;***
- ***Të insistohet në edukimin e vajzave, si nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse ashtu edhe nëpërmjet lehtësimit të procesit të regjistrimit të vajzave në shkollë 9 vjeçare dhe të mesme, apo materialeve didaktike;***
- ***Mbështetja dhe bashkëpunimi me organizatat që kanë në fokus gruan dhe dhunën me bazë gjinore.***

Moduli i tretë u fokusua në temën “Praktikat e mira të prindërimit”. Tema kishte për qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e rolit të prindërve në procesin e edukimit të fëmijëve. Kjo temë u trajtua në formë bashkëbisedimi, ku hera-herës kërkohej dhe ndërhyrja e prindërve për pyetjet që lindnin gjatë diskutimit.

REKOMANDIME

- *Të bëhen më shumë tema ndërgjegjësimi për rëndësinë e prindërimit, ku të jenë pjesëmarrës të dy prindërit;*
- *Të flitet me prindërit për rëndësinë e njohjes së fëmijës së tyre;*
- *Të trajtohet një temë specifike për rëndësinë e njohjes së emocioneve të fëmijëve;*
- *Të ndihmojmë prindërit të dinë të vlerësojnë fëmijët e tyre me aftësitë që ata kanë;*
- *Të bëhen tema të përbashkëta ndërmjet edukatoreve (mësues), prindërve si një lidhje e fortë dhe e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve;*
- *Të bëhen diskutime midis figurës së psikologut dhe të gjithë aktorëve që marrin pjesë në edukimin e fëmijëve.*

Nëntori është muaji i ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve. Nisur nga ky fakt moduli i katërt ju kushtua pikërisht kësaj teme, si një reflektim për ne si bashkëpunues për një mirëqenie dhe një zhvillim sa më progresiv të fëmijëve. Qëllimi i zhvillimit të kësaj teme ishte të kuptuarit e fëmijëve me gjithë të drejtat e tyre. Trajtimi i saj u bë në mënyrë të thjeshtëzuar dhe me shembuj konkret nga jeta e përditshme për tu bërë më e prekshme dhe e kuptueshme nga të pranishmit.

REKOMANDIME

- *Krahas temave të sygjera në trajnimin parardhës lidhur me edukimin dhe rëndësinë e tij në zhvillimin e fëmijëve do të ishte e volitshme që të trajtohen edhe tema me rëndësinë e njohjes së të drejtave të fëmijëve në jetën e tyre si të rriturit e së nesërme;*
- *Gjithashtu tema të rëndësishme dhe të domosdoshme kjo dhe si kërkesë e vet nënave do të ishin temat për njohjen e sjelljeve të fëmijëve, kuptimin e bërjes së një sjellje të caktuar si dhe menaxhimin e sjelljeve ‘problematike’.*



AKTIVITETE FESTIVE

8 prill, Dita Ndërkombëtarë e Romëve u nderua edhe këtë vit në kopshtet e targetuara nga projekti. Aktivitete festive u zhvilluan ku aktorët kryesore ishin fëmijët. Si çdo vit aktiviteti kishte për qëllim promovimin e vlerave, kulturës e traditës rome si dhe shpërndarjen e mesazheve ndërgjegjësuere për një bashkjetesë harmonike midis komuniteteve si dhe për të drejtat e njeriut. Të gjitha këto mesazhe u dhanë nga fëmijët nëpërmjet këngëve dhe recitimeve, por edhe nëpërmjet fletëpalojseve me informacion.

Bashkia Korçë, si gjithmonë prezente dhe e vëmendshme ndaj kopshtit “Lulet e vogla” ishte e pranishme në aktivitetin e zhvilluar nga kopshti. Kryetari i Bashkisë së Korçës, i shoqëruar nga stafi i tij dhuruan materiale dhe pajisje të tjera për të përmirësuar edhe më shumë cilësinë e mësimdhënies por edhe për argëtimin e fëmijëve. Ata premtuan për një vëmendje më të madhe ndaj fëmijëve rom dhe pjesëtarëve të komunitetit rom në përgjithësi.

Viti i Ri u festua me dhurata dhe aktivitete festive nga vogëlushët tanë. Është momenti i vitit të cilin ata e presin me më shumë dëshirë pasi gëzojnë, argëtohen dhe shijojnë dhuratat.







SHËRBIMI SHËNDETËSOR

Kontrolli shëndetësor për fëmijët, i ofruar nga mjekët e përfshirë në projekt, ka patur një ndikim pozitiv në përmirësimin e kushteve të përgjithshme shëndetësore të fëmijëve. Secili prej fëmijëve është i pajisur me kartelën shëndetësore. Përgjatë këtij viti, disa raste janë referuar për një vizitë më të specializuar shëndetësore tek mjekët specialistë. Mjekët referojnë nivele gjithmonë e më të ulëta të sëmundjeve infektive të lidhura me higjienën.

Seancat e këshillimit me prindërit mbi kujdesin parësor shëndetësor kanë kontribuar për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me parandalimin e sëmundjeve për fëmijët, por edhe gratë. Tema të trajtuara në këto seanca kanë qenë:

- **Gripi sezonal;**
- **Infeksionet e traktit respirator;**
- **Fruthi;**
- **Planifikimi familjar;**
- **Ushqimi i fëmijëve të moshës parashkollore;**
- **Kanceri i qafës së mitrës;**
- **Hepatiti B, simptomat, shkaqet dhe vaksinimi;**
- **Higjiena personale dhe sëmundjet ngjitëse;**
- **Bronkopneumonia;**
- **Infeksioni i traktit urinar;**
- **Vaksinimi i fëmijëve;**
- **Alergjitë sezonale;**
- **Anemia, shkaqet, simptomat dhe medikamentet;**
- **Zhvillimi psikomotor i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç;**
- **Kujdesi dentar tek fëmijët;**
- **Trajtimi i diarresë në shtëpi;**
- **Diagnoza e hershme e kancerit të gjirit;**
- **Gastroenteriti akut në fëmijët, shkaqet, simptomat, trajtimi;**
- **Autizmi, diagnoza e hershme dhe trajtimi etj.**

Shpeshtësia e kryerjes së vizitave shëndetësore për fëmijët në qendrat shëndetësore është rritur, duke treguar një interes më të madh nga prindërit për parandalimin e sëmundjeve tek fëmijët.

REGJISTRIMI CIVIL NDRYSHIMET NE LIGJ

Në vendin tonë vazhdojnë të jenë prezente problemet e pashtetësisë, kryesisht në komunitetin Rom dhe Egjiptian. Pjesërisht këto probleme lidhen me regjistrimin e lindjeve, kryesisht për rastet e fëmijëve që kanë lindur jashtë vendit, prindërit e të cilëve kryejnë lëvizje të shpeshta brenda dhe jashtë vendit. Prindërit shpesh nuk kanë dokumentet e nevojshme që përfshijnë informacionin bazë që nevojitet nga autoritetet shqiptare për të bërë regjistrimin e lindjes.

Në tetor të vitit 2018 Ligji për Gjendjen Civile pësoi disa ndryshime me qëllim lehtësimin e procedurave ligjore për shtetasit shqiptarë që nuk mund të regjistrojnë lindjen e fëmijëve tyre e si rrjedhojë fëmijët ngelin pa shtetësi, kryesisht për fëmijët e lindur jashtë vendit. Ndryshimet e reja në ligj do të synojnë të shmangin pengesat dhe vështirësitë aktuale, me qëllim eliminimin e fenomenit të pashtetësisë. Amaro-Drom, si një nga aktorët kyç që kontribuon në lehtësimin e regjistrimit të lindjeve të fëmijëve por jo vetëm, të komunitetit Rom dhe Egjiptian ishte pjesë e tryezës së rrumbullakët të mbajtur nga UNHCR, UNICEF dhe TLAS në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, ku u prezantuan ndryshimet e reja në Ligjin e Gjendjes Civile. Konkretisht pikat kryesore që kanë të bëjnë me lehtësimin e procedurave janë:

- 1. Të gjithë fëmijët e lindur jashtë territorit të Shqipërisë, që në aktet e tyre të lindjeve kanë pasaktësi ose janë të paplota, gjykata me anë të vërtetimit të faktit juridik të lindjes, do të detyrojë zyrat e gjendjes civile të bëjnë regjistrimin e tyre;**
- 2. Krijimin e regjistrit të përkohshëm për pasqyrimin e lindjeve në kohë reale të raportuara nga subjektet shëndetësore shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Nëse regjistrimi nuk kryhet brenda 60 ditëve nga dita e lindjes, zyra e gjendjes civile njofton njësinë për mbrojtjen e fëmijëve e cila është e detyruar të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të regjistruar rastin.**



HISTORI SUKSESI

ROKSANA 7 VJEÇ, QERIMI 5 VJEÇ,
ERINA 3 VJEÇ TASHMË KANË
NJË IDENTITET

Gjatë këtij viti u finalizua me sukses regjistrimi civil i tre fëmijëve të identifikuar në nëntor të vitit 2017 në Baltëz, Fier. Për shkak të kompleksitetit të rastit, ishte e nevojshme ndihma financiare dhe juridike e cila u mundësua falë mbështetjes së projektit. Familja e përfaqësuar nga një avokat ndoqi procedurat e nevojshme gjyqësore që u finalizuan me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile. Tashmë ata kanë akses të plotë në shërbimet publike e për më tepër kanë një identitet.

Shumë raste të tjera janë mbështetur në varësi të nevojës së rastit, duke siguruar ndihmë administrative apo edhe ndërgjegjësim në komunitetin e prindërve për të regjistruar fëmijët e tyre.

Nr.	Komunitetet	Rastet te identifikuara	Raste te zgjidhura	Raste ne Proçes	Sherbime te tjera
1	Korce	18 raste (5 - femra)	18 raste (5 - femra)	0	0
2	Morave	29 raste (9 - femra)	29 raste (9 - femra)	0	0
3	Baltez	42 raste (23 - femra)	42 raste (23 - femra)	0	3-Sherbime gjyqesore
4	Shkoder	15 raste (4 - femra)	15 raste (4 - femra)	3	3-Sherbime gjyqesore
5	Saver	53 raste (21 - femra)	53 raste (21 - femra)	0	0
6	TOTALI	157 raste (62 - femra)	157 raste (62 - femra)	3	6-Sherbime gjyqesore



EKSPERIENCË PERSONALE NATASHA QOSE

Natasha është prej 7 vitesh edukatore në kopshtin e lagjes „Stan” në Moravë. Më parë ajo ka punuar si mësuese Gjuhë-Letërsie në Berat. Pas një shkëputjeje nga puna si mësuese, Natasha u emërua edukatore në këtë kopsht. Më poshtë gjeni rrëfimin e saj mbi këtë eksperiencë:

„Rreth 7 vite më parë unë u emërova edukatore në Moravë. Nuk e njihja këtë zonë pasi nuk më kishte rënë rasti të punoja apo jetoja aty. Dija vetëm që kishte një përqëndrim të lartë të komunitetit Rom. Sic e dimë të gjithë, paragjykimet dhe diskriminimi ndaj këtij komuniteti atëherë ka qenë prezent dhe madje më i fortë se sot. Miqtë e mi ishin skeptikë rreth angazhimit tim si edukatore në këtë kopësht. Por familja ime më mbështeti dhe më shtyu t’a pranoja punën. Me gjithë dyshimet që kisha, u nisa drejt Moravës për të filluar ditën time të parë të punës pa e ditur se do ishte fillimi i një rrugëtimi të gjatë dhe të bukur.

Ajo që më bëri më tepër përshtypje në momentin e parë që hyra në klasë, ishte gjendja në të cilën ndodhej klasa, me disa rafte të boshatisur, tavolina të vogla e të papërshtatshme për të punuar dhe disa postera me fëmijë të uritur. Nuk ishte aspak motivuese të shihje atë pamje. Pas pak dëgjoj zërat gazmorë të fëmijëve të cilët po vinin në kopësht. Varfëria dhe kushtet e vështira në të cilat jetonin reflektohej qartë edhe në pamjen e fëmijëve. Por sytë e tyre ishin të mbushur me shpresë. Vendosa të punoja e të jepja kontributin tim maksimal në çdo aspekt. Këta fëmijë meritonin një të ardhme.

Sfidat ishin prezente, shumë fëmijë Rom që vinin për herë të parë në kopësht nuk mund të flisnin gjuhën shqipe dhe më duhet të gjeja një formë për të komunikuar, madje të mësoja fjalë nga gjuha rome. Isha e panjohur për fëmijët dhe fillimisht pranimi nga ana e tyre ishte i vështirë. Fatmirësisht në këtë rrugëtim nuk isha e vetme. Kisha mbështetjen e e znj. Alime

Avdiu, lidere komuniteti Rome, një grua e vendosur dhe kudogjendur, një njeri i respektuar nga komuniteti Rom në Moravë. Ajo lehtësoi këtë proces dhe vazhdon ende të jetë një bashkëpunatore e shkëlqyer në misionin tonë të përbashkët.

Si në çdo kopësht, puna filloi që me tualetin, higjenën e fëmijëve, sjelljen etike e më pas programin mësimor, si dhe ndërgjegjësimin e prindëve të cilët u treguan mirëkuptues në këtë aspekt. Sensibilizova miqtë e mi të cilët u treguan të gatshëm të dhuronin veshmbathje për fëmijët. Ajo që më jepte forcë për të qënë këmbëngulëse ishte dashuria që më jepnin fëmijët. Në mëngjes më prisnin që jashtë në rrugë dhe më mbulonin me përqafime. Dita ime fillonte bukur, ashtu si edhe tani. Më pas nisa të bëja vizatime me personazhet e përrallave në muret e kopshtit për t'a bërë ambjentin më të këndshëm për fëmijët. Sot kopshti ka një pamje krejtësisht ndryshe. Organizata më e madhe Rome në Shqipëri „Amaro-Drom“ ka mbështetur kopshtin me pajisje të reja dhe materiale didaktike të nevojshme për të zhvilluar një proces normal edukimi. Të gjithë së bashku kemi kontribuar që fëmijët të ndihen të sigurt, komodë dhe të lumtur në kopësht.

Një ditë vendosa të ftoj një grup kolegesh mësuese dhe nxënësit e tyre për të vizituar kopshtin tonë. U surprizuan nga kushtet e krijuara, me dashurinë, sjelljen e edukuar të fëmijëve të mi. Puna ime kishte filluar me moton “Gjërat që na bashkojnë janë më të mëdha se ato që na ndajnë.” U larguan nga kopshti me përshtypjet më pozitive dhe me dëshirën për t'u rikthyer e për të vizituar sërish fëmijët. Më pas pjesë e kopshtit u bënë edhe disa fëmijë të mazhorancës, banorë të lagjes sonë, por që deri në atë moment kishin frekuentuar kopshtin e qendrës. Mes fëmijëve Rom dhe jo Rom divergjencat erdhën duke u zbutur dhe tashmë nuk egzistojnë. Shprehjet “na ndajnë e na bashkojnë” nuk vlejnë më.



Natasha Qose

Kopshti “Stan” Moravë - Berat
